



Sot është shkarkuar trajneri i Pogradecit Ardian Abazaj. Shkaku kryesor i shkarkimit të tij ka qenë mungesa e rezultateve nga skuadra Pogradecare. Shkarkimi nga detyra, trajnerit Abazaj i është komunikuar nga drejtuesit e Bashkisë së qytetit. Duhet theksuar se skuadra liqenore kishte plot kater ndeshje që nuk njihen shijen e fitores. Fitorja e fundit nën drejtimin e trajnerit të Abazaj ka qenë ajo 2 Nëntorit, ndaj Dinamos 1-0, në Stadiumin “Gjorgji Kycyku” të Pogradecit.

Menjëherë pas largimit të trajnerit Abazaj, drejtuesit e Bashkisë të qytetit liqenor kanë emruar trajnerin e ri. Behet fjale për Arben Mahmutajn, i cili kryen njëherazi dy detyra atë të sekretarit të klubit dhe të trajnerit të moshave (U19). Interesant është fakti se skuadra (U19), e drejtuar nga sekretari Mahmutaj, aktualisht ndodhet në vendin e fundit në renditje. Gjithashtu, duhet përmendur që skuadra pogradecare ka më shumë se pesë muaj që nuk është paguar nga Bashkia e qytetit aktualisht sponsorja kryesore e skuadës liqenore. Ish trajneri Abazaj nuk ka pranuar të komentojë vendimin e drejtuesve bashkiak, por kuptohet që situata ku është katandisur skuadra qytetit të tij është rrjedhojë e gjendjes jo të mirë financiare ku është mberthyer prej pesë muajsh. Për dy javësh futbollistët e skuadës liqenore bojkotuan seancat stërvitore për shkak të mos respektimit të shlyrjes në afat të pagesave mujore. Trajneri i ri Mahmutaj do të ketë debutimin e tij të parë këtë fundjavë në Pogradec, ndaj Luftëtarit të vendit të parafundit.